



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:253115

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726303

C.nr.4033/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.Sh. nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson M.Sh. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e pagës jubilarë, vlera e kontestit 591.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.Sh. nga Prishtina, dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, që të ia paguaj, paditësit Venet Shala, në emër të kompensimit të pagës jubilarë, shumën prej 591.16 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë me 08.02.2022, e deri në përmbushjen definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi V.Sh. përmes të autorizuarit të tij av. M.Sh. nga Prizreni, me datën 21.11.2023 ka parashtruar padi për kompensimin e pagës jubilarë, kundër të paditurës Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren.

Në padi, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditëst asnjëherë nuk i është bërë kompensimi në emër të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë e paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2021. Duke u bazuar në nenin 35, par.8 i cili thotë se “*Punëtorët (antarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundi, me vlerë të 50% të një page bazë, 8.2 Për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. Për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75% të një page bazë, 8.3. Për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. Për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë, 8.5. Shpërblimit jubilar paguhet nga punëdhënësi,*

kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, 8.6. shpërblimit jubilar paguhet me rastin e 7 marsit të çdo viti. Andaj, paditësi me padi kërkon që në emër të kompensimit të pagës jubilarë të kompensohet në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e kontratës kolektive me datën 22.01.2021.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të palejuar për faktin se: Pretendimi për vitin 2022 mbetet i pa qëndrueshëm juridikisht ngase kontrata kolektive është shfuqizuar. Në asnjë pretendim pala nuk ka arritur të argumentojë se i takojnë të drejtat e tilla. Vlen të ceket se gjatë vitit 2020 dhe 2021, në përputhje me situatën e krijuar nga Pandemia Covid-19, si de duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe Senatit të Universitetit, ku mësimi është mbajtur në platformat online, pa prani fizike në Universitet, andaj propozojmë që të hedhet poshtë padia e paditësit si e palejuar. Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren është në vijë buxhetore e MASHT, pra si në universitet ende nuk kemi pavarësi financiare dhe si rrjedhojë e kësaj ne nuk kemi kategori të caktuar për pagesa të tilla dhe nuk na lejohet pagesa e beneficioneve që burojnë nga Kontrata Kolektive.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si Profesor Asistent në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

Gjykata përmes kontratës me nr. protokollit 06-28 të datës 16.02.2021 dhe vendimit me nr.03-51 të datës 03.03.2021 të lëshuar nga e paditura, për paditësin Venet Shala vërtetoi faktin se i njëjti ka 15 vite e 6 muaj përvojë pune si asistent në Fakultetin e Ekonomisë - Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, ka themeluar marrëdhënie pune në këtë institucion duke nënshkruar kontratë të rregullt e cila hyn në fuqi nga 16.02.2021.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, vërtetimet e Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me përvojën në punë, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.8, nënpar.8.3 të KKAK-së është paraparë se “*Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërbilimin jubilar në vlerë: për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë*”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit t’ia paguaj kompensimin për pagën jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 euro.

Lidhur me kamatën. Gjykata ka vendosur konform Nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që e ka aprovuar kamatën në lartësi prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4033/23, datë 23.05.2024

G j y q t a r j a
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.